



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI EKONOMIK

EGZONA HASANI

# **MODELET E ZHVILLIMIT TË PRODUKTEVE TË REJA NË SISTEMIN BANKAR NË KOSOVË**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori: Prof. Dr. Asoc. Besim Beqaj

Prishtinë, 2023

# Abstrakti

Ndikimi i globalizimit në zhvillimet e përgjithshme në të gjitha sferat e jetës dhe efektet që tanimë ka shkaktuar bën që shumë veprimtari ekonomike të pregaditen për ndryshime rapide. Ndryshimet sjellin me vete edhe shumë risi ku në trendet e tanishme të të jetuarit kanë bërë që shumë zhvillime në një pjesë të globit të kenë efekt në anët e tjera në të njejtën kohë. Këto efekte të ndryshimeve mund të vërehen në shumë veprimtari të cilat janë të lidhura dhe të varura nga teknologjia informatike. Sistemi bankar hyn në veprimtaritë të cilat janë të varura nga zhvillimet e reja teknologjike, andaj si pjesë shumë të rëndësishme të ekonomisë botërore, bankat janë fokusuar që produktet dhe shërbimet e reja t'i përshtasin me trendet aktuale zhvillimore.

Duke u bazuar në zhvillimet teknologjike, produktet dhe shërbimet e reja bankare duhet të krijohen konform kërkesave të klientëve të tyre. Kërkesat e klientëve bankar janë të përqendruara në produkte të përdorura lehtë, kryesisht të lidhura me teknologjinë informatike, produkte që kursejnë kohën dhe janë efikase njëkohsisht. Këto kërkesa dhe shumë të tjera të cilat burojnë nga trendet e të jetuarit të shpejtë, bankat tanimë kanë filluar t'i përmbushin me anë të produkteve të tyre të reja. Për ofrimin e modeleve dhe zhvillimit të produkteve të reja bankare në Kosovë, disertacioni shtjellon në detaje duke filluar nga ideja deri në rrugëtimin përfundimtar kur një produkt bankar ofrohet për tregun dhe për klientët.

Punimi doktoral përbëhet nga gjashtë kapituj. Secili nga kapitujt në përmbajtjen e tij shtjellon detaje të rëndësishme të cilat paraqiten në formë të kjartha dhe kuptimplote duke u mbështetur në literaturë të ndryshme si dhe nga puna ime hulumtuese në terren. Secili kapitull ka përmbajtje gjërë me materiale të zgjedhura dhe të paraqitura në formë koherente. Filluar me kapitullin e parë mbi përshkrimin e shkurtër mbi hulumtimin kërkimor dhe rëndësinë e tij, definimin e problemit, objektivat e punimit, pyetjet hulumtuese, metodologjinë dhe kontributin e pritur shkencor. Kapitulli i dytë ka të bëjë me shqyrtimin e literaturës. Filluar me spjegimet mbi përkufizimin e sistemit bankar, bankat bashkohore dhe produktet e tyre, trendet globale të bankave si dhe përshkrimin e sistemit bankar në Kosovë. Shumë hapësirë i është kushtuar marketingut në këtë kapitull përfshirë mediat sociale, nano-marketingu, marketingu 4 dhe 5. Përkufizimi i produktit të ri, zhvillimi i qëndrueshëm i produkteve të reja, fazat e ciklit jetësor të produktit të ri, si dhe strategjitë e produktit të ri dhe inovativ. Ndikimi i teknologjisë informatike në banka dhe në produktet e reja bankare. Poashtu ndikimi i burimeve njerzore në zhvillimin e

produkteve të reja janë disa nga të dhënat që e pasurojnë këtë kapitull. Kapitulli i radhës, kapitulli i tretë, metodologjia e hulumtimit paraqet metodologji të cilat ofrojnë të dhëna dhe sqarime lehtë të kuptueshme mbi proceset, teknikat, organizimin dhe zhvillimin e produkteve të reja bankare. Modelet AHP (Analytical Hierarchy Process) apo Procesi Analitik i Hierarkisë si dhe modeli i biznesit Canvas. Të gjeturat dhe të dhënat e hulumtimeve për bankat në Kosovë janë pjesë e kapitullit të katërt. Analiza e të dhënave duke i paraqitur në përmbledhje të dhënave primare të gjeneruara nga përgjigjet e pyetësorëve dhe punës hulumtuese në terren të cilat paraqiten me anë të grafikoneve, tabelave dhe figurave. Kapitulli i pestë përmban një përmbledhje të autores mbi produktet e reja bankare. Poashtu janë të dhëna konkluzionet dhe rekomandimet për zhvillim e produkteve të reja bankare Përfundimet të shprehura në formë rikapitullimi mbi bankat produkte e tyre, rëndësinë e produkteve të reja bankare si dhe pyetsorët e bankave, bizneseve dhe individëve janë të paraqitura në këtë kapitullin poashtu. Punimi përmbillet me kapitullin mbi literaturën e përdorur si dhe burimet e të dhënave.

Punimi doktoral shpalos shumë detaje të cilat janë një kombinim i hulumtimit të gjatë dhe përmbajtësor duke u bazuar në literatura të shumta si dhe ekzaminimet e kryera gjatë punës hulumtuese personale. Të gjitha të gjeturat nga të dhënat primare dhe poashtu ato sekondare janë bashkuar duke ofruar një vlersim dhe pasqyrim adekuat të rëndësisë së zhvillimit të produkteve të reja në sistemin bankar në Kosovë.

*Fjalët kyqe: bankat, produktet e reja, teknologjia, klienti, globalizimi*